

# KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



**I**nformim  
**D**he  
**P**rivatësi

**Nr.1**

**Korrik 2016**

---

## **Përmbajtja**

Editorial.....	faqe 3
Konkursi “Mbro privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet”.....	faqe 4
Konferenca II kombëtare “Për të Drejtën e informimit/pyetshtetin.al”.....	faqe 8
Portali pyetshtetin.al.....	faqe 10
Konferencat rajonale “Për të drejtën e informimit”.....	faqe 11
Takime në universitete.....	faqe 12
Takime në shkollat e mesme.....	faqe 14
Trajnime në Shkollën e Magjistraturës.....	faqe 15
Takim trajnues me zëdhënësit e Policisë së Shtetit.....	faqe 15

## **Revista “Informim Dhe Privatësi”**

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Adresa: Rr. e Kavajës, Nd. 80, H. I, K. 5, Tiranë.

Drejtues: Irma Arapi.

Redaksia: Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj.

Print:

Botimet Onufri

Korrik 2016

## Editorial



## Z. Besnik Dervishi

**Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

I nderuar lexues!

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë janë të sanksionuara dy të drejta themelore të individit, e drejta për t'u njohur me dokumentat zyrtare, ose ndryshe, e drejta për t'u informuar për aktivitetin e autoriteteve publike dhe ajo e mbrojtjes së privatësisë, ose garantimi i ruajtjes së të dhënave personale. Këto të drejta përbëjnë edhe dy nga shtyllat kryesore të demokracisë së re shqiptare. Ato duhet të trajtohen në harmoni dhe balancë me njëra-tjetrën, për të konsoliduar dhe përmirësuar modelin politik të shoqërisë në të cilin kontribuojmë të gjithë si qytetarë.

Është përgjegjësi e Zyrës së Komisionerit që të nxisë, nëpërmjet zbatimit të plotë të kuadrit ligjor, luftën ndaj korrupsionit dhe kulturën për një administratë publike të hapur për qytetarët. Ndërsa, grumbullimi, përpunimi, ruajtja apo shkatërrimi i rregullt i të dhënave personale është një nga elementët më të rëndësishëm të zhvillim dinamik ekonomiko-shoqëror të vendit. Përmirësimi në vijimësi i aspektit ligjor dhe zbatimi i praktikave më të mira dhe bashkëkohore administrative nga Autoriteti ynë, janë, gjithashtu, garanci për mbikqyrjen efektive të procesit të respektimit të këtyre të drejtave, si nga autoritetet publike, ashtu edhe nga kompanitë private.

Nëpërmjet këtij botimi, Zyra e Komisionerit vjen pranë jush me një mënyrë tjetër komunikimi, si një kontribut për më shumë ndërgjegjësim në ushtrimin në praktikë të këtyre të drejtave. Kam kënaqësinë t'ju prezantoj numrin e parë të Revistës "Informim Dhe Privatësi" Ky do të jetë një botim periodik, 2 herë në vit, ku do të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur aktivitetet kryesore të Zyrës së Komisionerit.

Lexim të mbarë!

## Kur bëhet fjalë për privatësinë, është më mirë të parandalohet dëmi, se sa ta përmirësosh atë pasi ka ndodhur fakti.

28 Janar 2016,

Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Ceremonia e ndarjes së çmimeve të konkursit “Mbro privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet”. Në këtë aktivitet të organizuar nga Zyra e Komisionerit, me bashkëpunimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, morën pjesë 21 shkolla 9-vjeçare nga 17 qytete të vendit. Nxënësit paraqitën më shumë se 500 punime në kategorinë vizatime/ pikturë dhe ese/ poezi.





Aktiviteti u zhvillua në mjediset e bibliotekës së Galerisë Kombëtare të Arteve. Z. Besnik Dervishi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerësoi, *“se në epokën digjitale edukata për ruajtjen e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave duhet të merret që në bankat e shkollës”*.

Në këtë ceremoni morën pjesë si të ftuar nderi znj. Dewi van de Weerd, ambasador i Mbretërisë së Holandës; znj. Nora Malaj, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit; z. Olsi Dekovi, përfaqësues i Këshillit të Evropës në Shqipëri; znj. Vilma Baçe, përfaqësuese e Raiffeisen Bank dhe znj. Arlinda Dudaj nga Botimet Dudaj – mbështetës të këtij aktiviteti, si dhe nxënës e mësues të shkollës 9-vjeçare “Jeronim de Rada” të Tiranës.



## Punimet e konkursit

### “Mbro privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet”



Jimena Qarri  
Shkolla “Sevasti Qiriazi” Korçë




Eden Fetahu  
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë



Olvi Xhaferraj  
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë



Pamela Hajdëraj  
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë



Sara Sali  
Shkolla "Papa Kristo Negovani" Ersekë

Ç'është kjo bota e internetit,  
dikush duhet të na mësojë,  
ç'dëme sjell tek ne të vegjlit,  
pse s'na lënë që të lundrojmë?

Kur na qenka e ndaluar,  
pse çdo shëpi kompjuter ka,  
pse tablet mbajnë në duar,  
pse gjithmonë rrimë online?

Interneti nuk është i gabuar,  
por edhe të këqija ka,  
është një botë shumë e trazuar,  
se kuptojmë, duhet të rritemi edhe ca.



Megi Minxolli  
Shkolla "17 shkurti" Qesarakë, Tiranë

Puno: Kledi Saliko  
Shkolla "Naim Frashëri" Fier  
III A

## Konferenca II kombëtare “Për të Drejtën e Informimit/pyetshtetin.al”



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi, më 29 prill, në bashkëpunim me Fonacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – Soros, **Konferencën e 2-të kombëtare “Për të Drejtën e Informimit/pyetshtetin.al”**. Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 200 përfaqësues të institucioneve qendrore, atyre të vetëqeverisjes vendore dhe të sistemit të drejtësisë nga i gjithë vendi.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, mbajti prezantim përmbledhës për vlerësimin e zbatimi e ligjit “Për të drejtën e informimit” nga Autoritetet Publike. Që prej hyrjes së tij në fuqi në nëntor të vitit 2014, Zyra e Komisionerit ka konsoliduar funksionimin e saj administrativ; ka mbikëqyrur përmbushjen e detyrimeve për hartimin e Programit të Transparencës dhe emërimin e koordinatorit për të drejtën e informimit nga Autoritetet Publike; si dhe ka trajtuar rreth 500 ankesa të qytetarëve.

Z. Dervishi, theksoi gjatë fjalës së tij, se **“Zyra e Komisionerit ka reflektuar praktikat dhe eksperiencat më të mira evropiane në fushën e të drejtës për informim”**. Ndërsa, vlerësoi, se **“është koha e duhur, nga përvoja e përfituar nga zbatimi i ligjit, që Autoritetet Publike të pasqyrojnë specifikat e sektorëve respektivë në Programet e tyre të Transparencës”**. Gjithashtu, ai tha se stafi i Zyrës së Komisionerit ka trajtuar në disa aktivitete kombëtare dhe rajonale përfaqësuesit dhe koordinatorët e Autoriteteve Publike si qendrore, ashtu edhe ato të vetëqeverisjes vendore.



## Konferenca II kombëtare “Për të Drejtën e Informimit/pyetshtetin.al”

Punimet e kësaj Konferencës i përshëndetën me fjalë rasti të ftuarit e nderit znj. Valentina Leskaj, nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; Milena Harito, ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike; z. Andi Dobrush, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe znj. Dewi van de Weerd, ambasador i Mbretërisë së Holandës në Shqipëri.

Të ftuara të veçanta, ishin gjithashtu edhe znj. Rosemary Agnew, Komisioner i Skocisë për të Drejtën për Informim dhe znj. Anamarija Musa, Komisioner i Kroacisë për të Drejtën për Informim. Ato mbajtën prezantime për trajnimin e të pranishmëve me praktikatat më të mira, si dhe trajtuan disa raste konkrete në këtë fushë nga vendet e tyre.

Në Konferencë u prezantua portali **pyetshtetin.al**, platforma online që ka për qëllim t’u vijë në ndihmë qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit për të patur një akses më të madh në informacionin me karakter publik. Zyra e Komisionerit dhe Fondacioni Soros kanë bashkëpunuar prej disa kohësh për ngritjen e këtij portali.

Kjo platformë online u ofron qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit mundësi të shumta për ushtrimin e të drejtës së tyre për t’u informuar me dokumentat zyrtare. Në portal mund të konsultohet lehtësisht Programi i Transparencës dhe lista e koordinatorëve të Autoriteteve Publike, ndërsa në platformë është përfshirë edhe Regjistri Kombëtar i Kërkesave për Informim të regjistruara prej tyre.



# Portali pyetshtetin.al

Më shumë se 2700 qytetarë vizituan në muajin e parë të funksionimit të tij portalin **pyetshtetin.al**. Në raportet e monitorimit për periudhën 25-30 prill dhe për periudhën 1-25 maj 2016, të publikuara në faqen zyrtare në internet të Zyrës së Komisionerit, do të gjeni të dhëna për numrin e përgjithshëm të vizitorëve dhe për faqet më të kërkuara në këtë platformë. Gjithashtu, ka statistika për numrin në rritje të vizitorëve të rikthyer, në raport me ata që shfaqin vetëm një herë interes për portalin. Vlen të theksohet fakti, se ka një interes të shtuar për këtë platformë nga jashtë vendit, ndërsa, edhe kohëzgjatja e qëndrimit në portal është një tregues për t'u marrë në konsideratë.

**PORTALI "PYET SHTETIN"**

Portali "Pyet Shtetin" është një platform online, e cila ka për qëllim të ndihmojë qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit për të patur një akses më të madh dhe për të gjetur më me lehtësi informacionin me karakter publik. Portali synon gjithashtu të lehtësojë procedurat e dërgimit të kërkesave për informim ndaj çdo autoriteti publik përgjegjës si dhe të ankesave në rast refuzimit të informacionit të kërkuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përmes shfrytëzimit të këtij protali, çdo qytetar apo/dhe çdo grup interesi mund të dërgojë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesat për informim apo


[Më shumë](#)

**PUBLIKIME**

Fletëpalosje: Si të bëni një kërkesë për informim [Më Shumë](#)

Ligji për të Drejtën e Informimit [Më Shumë](#)

Kjo statistikë tregon sesa vizitorë nga shtete të ndryshme kanë vizituar faqen tuaj.



## Konferencat rajonale “Për të drejtën e informimit”

Zyra e Komisionerit zhvilloi në Elbasan, Gjirokastër e Berat konferencat rajonale “E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e transparencës”. Ato kishin për qëllim të njihnin dhe të trajnonin përfaqësuesit e strukturave të pushtetit vendor, si dhe atyre të institucioneve qendrore në nivel vendor, me detyrimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në përfundim të procesit të riorganizimit të organeve të vetëqeverisjes vendore nga zbatimi i reformës administrativo-territoriale. Z. Besnik Dervishi, vlerësoi faktin se nxitja e kulturës së transparencës nga Autoritetet Publike është domosdoshmëri për një administratë moderne, të përgjegjshme dhe efikase në shërbim të qytetarëve.



Elbasan



Berat



Gjirokastër

## Takime informuese për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në universitete



Tiranë

Zyra e Komisionerit zhvilloi takime informuese në universitetet publike të Tiranës, Elbasanit, Shkodrës dhe të Gjirokastrës.

Në këto aktivitete studentët dhe pedagogët u njohën me aspekte të ndryshme të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe të të drejtës për informim. Të pranishmit u njohën me funksionimin e institucionit dhe rolin e tij në garantimin e këtyre dy të drejtave kushtetuese.



Shkodër



Elbasan



Gjirokastrë



Vlorë

## “Privatësia dhe siguria e të dhënave gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga të rinjtë”



Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me DAR dhe drejtoritë e shkollave të mesme të përgjithshme të Tiranës, Vlorës, Elbasanit e Gjirokastrës, zhvilloi 20 takime në kuadër të fushatën ndërgjegjëse “Privatësia dhe siguria e të dhënave gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga të rinjtë” me nxënës e mësues të gjimnazëve të këtyre qyteteve. Ky projekt u realizua gjatë periudhës janar-qershor 2016.

Të rinjtë u informuan për aspekte të ndryshme të përdorimit të sigurt të internetit dhe rrjeteve sociale. Gjatë takimeve u trajtuan raste konkrete të keqpërdorimit të të dhënave personale nga vetë të rinjtë, ndërsa, ata u njohën me mjete e mënyra për të shmangur shkeljen e privatësisë dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Nxënësit u treguan mjaft aktivë në plotësimin edhe të një pyetësoi të përgatitur për të identifikuar shkallën dhe problematikat e përdorimit të rrjeteve të sociale. Rezultatet e tij do të publikohen së shpejti në faqen zyrtare në internet të Zyrës së Komisionerit.



Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, zhvilloi 2 seminare trajnuese me temë “Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, në të cilat ishin të ftuar si lektorë z. Besnik Dervishi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe znj. Pjerina Gaxha, drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Në këto seminare morën pjesë gjyqtarë nga gjykatat e të gjitha niveleve.

Në seminare u trajtuan aspekte ligjore, problematika e raste konkrete të konstatuara gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve dhe nga procesi i kryerjes së hetimeve administrative. Të pranishmit u njohën me të drejtat e subjektit të të dhënave personale (individin) dhe me ligshmërinë e përpunimit të këtyre të dhënave nga kontrollues publikë apo privatë; risitë në procesin e hetimit administrativ në këndvështrimin e Kodit të ri të Procedurës Administrative, pas hyrjes së tij në fuqi në muajin maj 2016; mbrojtja e të dhënave në sistemin gjyqësor, veçanërisht, anonimizimi i tyre; praktika të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut edhe risitë pas hyrjes në fuqi të Rregullores së re të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Bashkimin Evropian.



Takim trajnues me zëdhënësit e Policisë së Shtetit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për informim.

# “Informim Dhe Privatësi”



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

**Rruga e Kavajës, Nd. 80, H. I, K 5, Tiranë**

**[www.idp.al](http://www.idp.al)**

**[info@idp.al](mailto:info@idp.al)**

**+355 42237200**

**0800 2050**